



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:272086

Datë: 03.07.2020

Numri i dokumentit: 01005215

A.nr. 101/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, me bashkëpunëtoren profesionale Mirjeta Shala, në konfliktin administrativ të paditëses StoneCastle Vineards&Winery, me seli në B.-Rahovec, e përfaqësuar nga Rexhep Gjikolli, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë në Prishtinë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, për shkak të “anulimit të vendimit”, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 05.03.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprobhet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses StoneCastle Vineards&Winery, me seli në B.-Rahovec.

II. ANULOHET Vendimi Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë, Komisionit për Shqyrtimin, Vlerësimin e Ankesës pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës Nr.167/2017 datë 22.12.2017.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 Ligjit Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (më tutje LKA-së), në prani të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore (Provë: fletë kthesa e datës 21.02.2020), e cila me parashtresën e datës 28.02.2020 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të marrë pjesë në seancën e datës 05.03.2020 dhe duke kërkuar nga gjykata që të veprojë konform nenit 38.5 e LKA-së.

Paditësja me datën 22.01.2018, në këtë gjykatë ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi i Komisionit për Shqyrtimin, Vlerësimin e Ankesës pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës Nr.167/2017 datë 22.12.2017, dhe të detyrohet Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë Prishtinë, që në emër të subvencioneve për verën e prodhuar në vitin 2016 paditëses të i'ia paguan shumën prej 236.707,56 euro në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit ose që Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë-Divizioni për Pagesa direkte i rekomandohet që në të njëjtin afat verifikimi i sasisë së verës së prodhuar në vitin 2016 nga paditësja, në subvencionet për verën e prodhuar në këtë vit, si dhe të detyrohet e paditura në pagimin e shpenzimeve të procedurës. Më tutje paditësja në padi ka theksuar se me rastin e aplikimit pranë Departamentit të për Vreshtari dhe Verëtari në Rahovec, kishte bashkangjitur tërë dokumentacionin e kërkuar. Në bazë të kësaj ftese subvencionimi do të bëhej për litër verë të prodhuar nga 0.04 euro. Paditësja me rastin e aplikimit në datë 27.12.2016 kishte deklaruar 989.561 litra verë të prodhuar, kurse me datën 30.12.2016 kishte deklaruar 4.928.128 litra verë gjithashtu të prodhuara, gjithsej 5.917.689 litra, dhe në bazë të thirrjes për aplikim paditësja do të realizonte nga 0.04 euro për çdo litër, apo gjithsej shumën prej 236.707,56 euro. Paditësja në bazë të dy projeksioneve për pjesëmarrje për realizimin e të drejtës së subvencionit të ofruar nga e paditura, paditësja pranë Departamentit kompetent, në bazë të ftesës kishte deklaruar gjithsej 5.917.689 litra verë të prodhuara, ku afati ka qenë deri me 15.01.2017. Pas konfirmimit të të dhënave dhe fakteve me datë 16.10.2017 Inspektorët e të paditurës kishin pranuar vetëm prodhimin prej e 989561 litra verë për vitin 2016. Përfaqësuesit e paditëses kanë bërë vërejtje në procesverbal të kontrollit duke potencuar se janë prodhuar vetëm 5.917.680 litra ndaj të cilit konstatim paditësi ka bërë ankesë. Komisioni i ankesave duke vendosur sipas kësaj ankese, me vendimin nr.3727 të datës 08.11.2017 Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë-Divizioni për pagesa direkte është rekomanduar që të verifikojë gjendjen dhe të bëjë kontrollën në teren me qëllim të verifikimit të sasisë së verës së prodhuar. Mirëpo i njëjti komision me datën 22.12.2017 merr vendimin nr.167/17 dhe e refuzon ankesën e paditëses si të pabazuar me arsyetimin se paditësja nuk ka deklaruar pranë Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë të dhënat e prodhimit vjetorë të verës për vjeljet e viti 2016 në afatin e paraparë deri i me datën 15.01.2017. Paditësja konsideron se vendimi i atakuar është jo ligjorë, arsyet e refuzimit të kërkesës janë në kundërshtim me të dhënat dhe dokumentacionin të prezantuar nga paditësja. Në arsyetimin e këtij vendimi përveç tjerash thuhet se "Komisioni vërtetoi si të ligjshëm vendimin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me Nr. Ref. ZHB 07/04/02-029548/2017 pasi që fermeri nuk ka deklaruar sasinë e verës së prodhuar gjatë viti 2016" të cilin vendim paditësja kurrë nuk e ka pranuar. Nga referati i padisë shihet se paditësja ka bërë

aplikimin me kohë si pjesëmarrës në realizimin e subvencioneve me kohë ashtu siç edhe parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2017 neni 28 par.1, nën par 1.3.

I autorizuari i paditëses në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe referatit të saj, mbes pranë propozimeve për provat e propozuara të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që të anulohet vendimi kontestues i të paditurës i dt. 22.12.2017 me nr. 167/17, i kundërshtoj të gjitha thëniet në përgjigje në padi. Kompania konsideron se në rastin e aplikimit për subvencione i ka plotësuar kushtet e parapara në udhëzimin administrativ i cili e rregullon këtë çështje, sipas kritereve të përcaktuara nga ana e palës së paditur si dhe i kërkoj shpenzimet procedurale.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 24.10.2019, e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, dhe ka kërkuar nga gjykata që pas shqyrtimit kryesorë të nxjerrë aktgjykim me të cilin e refuzonë kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Më tutje, e paditura në përgjigje në padi ka theksuar se gjatë kohës së aplikimit për pagesa direkte 2017 ka aplikuar paditësi në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë për pagesa direkte për verën e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht për 5917689.00 L verë. Në përputhje me nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenin 28 i Udhëzimit Administrativ nr.03/2017 për pagesa direkte për vitin 2017, Drejtoria e Pagesave Direkte, ka kryer kontrollin administrativ, vlerësimin e lëndës, me këtë rast vetëm shumë prej 989561.00L është aprovuar pasi që pjesa tjetër e deklaruar në aplikacion nuk figuron gjatë kohës së aplikimit por pas mbylljes së afatit të aplikimit, duke marrë për bazë edhe thirrjen për aplikim të datës 04.05.2017 me numër ..., ku iu është bërë thirrje kompanive prodhuese se mund të aplikojnë për pagesa direkte për verën e prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht nëse i përmbushin kriteret. Pas kontrollimit administrativ, lënda e aplikuesit ka dalur në teren për të konstatuar gjendjen faktike, kështu që me datën 16.10.2017 është kryer inspektimi në vend të ngjarjes dhe është konstatuar se fermeri ka 959561.00L verë ashtu si është bërë deklarimi zyrtarë në DVV, dhe nisur nga kjo gjendje AZHB ka nxjerrë vendim për pagesë me datën 30.11.2017, në vlerë prej 39,582.44€.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të datës 05.03.2020 ka administruar provat relevante: projektioni i pjesëmarrjes së varieteteve në prodhimin e verërave kulaitative dhe kulminante e dt. 27.12.2016 me nr. te dosjes 0107, projektioni i pjesëmarrjes së varieteteve në prodhimin e verërave kulaitative dhe kulminante e dt. 27.12.2016, e protokolluar me dt.30.12.2016 me nr.323, lajmërimi përfundimtar i vjeljes së rrushit, me nr. protokollit 313, i dt. 28.12.2016 me nr. te regjistrimit të firmës 16010/2014, e-maili i dt. 04.05.2017, formulari për aplikim me nr. 20/59904, i dt. 10.05.2017,

procesverbal i kontrollit për pagesa direkte me nr. 20/59904, i dt. 16.10.2017, ankese e protokolluar me dt. 26.10.2017, me nr.6765, vendimi me nr. 110/17, i dt. 08.11.2017 e protokolluar me dt. 08.11.2017 me nr. 3727-2, vendimi me nr.167/17, i dt. 22.12.2017 e protokolluar me dt. 22.12.2017 me nr. 3727-3, shkresa e dt.22.10.2019 me nr. 45/2019, thirrje për aplikim e protokolluar me dt. 04.05.2017 me nr. 1386, vendimi për pagese direkte i dt. 30.11.2017, me nr. ref. AZHB n07/4/2-029548/2017

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses **është e bazuar**.

Nga aktvendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 46 këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 47 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Aktvendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se *"Komisioni, duke u bazuar në ankesën e parashtruar nga Stone Castle Vineyards & Vinery L.L.C. nga Komuna e Rahovecit dt.26.10.2017 gjatë shqyrtimit, vlerësimit, administrimit të gjitha provave të afuara, vërtetoi, se ankesa është e pa bazë dhe është e kundërligjshme me nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, nenit 28 paragrafi 1.3, nenit 38 paragraf 38 par.2, nën par 2.15, nenit 40 paragrafi 3,5 si dhe nënti 41 paragrafi 1, 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ MBPZHR nr.03/2017 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2017 të datës 15.02.2017 duke konstatuar se ka shkelje të mos përmbushjes së kritereve dhe procedurave*

administrative të përcaktuara në legjislacionin sekondar në fuqi sepse nuk i ka deklaruar të dhënat e prodhimit vjetor të verës për vjeljet e viti 2016, deri me 15 janar 2017 në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë". Komisioni vërtetoi si të ligjshëm, vendimin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë me Nr.Ref.AZHB 07/4/2-029548/2017 pasi që fermeri nuk ka deklaruar sasinë e verës së prodhuar gjatë vitit 2016."

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referuar Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.03/2017, ku me nenin 4, par.1, "Me qëllim të shtimit të të ardhurave të bujqve për të siguruar një qëndrueshmëri ekonomike, pagesat direkte bëhen për:...1.5. Kompanitë prodhuese për verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht", ndërsa me nenin 28 të po këtij udhëzimi është paraparë që "Kriteret që duhet të plotësojnë kompanitë prodhuese të verës, janë: 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; 1.2. Aplikuesit duhet që deri më datë 10 Dhjetor 2016 në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë të deklarojnë të dhënat për deklarimin përfundimtar të vjeljes së rrushit për vjeljet e vitit 2016, 1.3. Aplikuesit duhet që deri më datë 15 Janar 2017 në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë të deklarojnë të dhënat e prodhimit vjetor të verës për vjeljet e vitit 2016., 2.Subvencionimi bëhet për litër verë të prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht, në vlerë prej 0,04 euro/litër.

Në këtë kuptim gjykata gjen se paditura vendimin e atakuar me padi e ka marrë pa dispozitiv të saktë dhe pa arsyetim, duke cituar si më lartë, duke marrë një vendim i cili nuk përmban elementet kryesore të vendimit të përcaktuar me dispozitat ligjore të cekura më lartë të Procedurës Administrative. Për më tepër e paditura në dispozitivin e vendimit të atakuar nuk e ka cekur se cilin vendim e ka lënë në fuqi. Po ashtu në vendimin e atakuar e paditura nuk ka theksuar mbi cilat prova konkrete e njëjta ka vërtetuar faktin se paditësi nuk ka dëshmi përkatëse për çështjen kontestuese, por vetëm ka dhënë një arsyetim të përgjithshëm pa e vërtetuar në mënyrë të plote gjendjen faktike.

Pretendimin e të paditurës se paditësja nuk i ka deklaruar të dhënat e prodhimit vjetor të verës për vjeljet e vitit 2016 deri me 15 janar 2017 në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë, kjo gjykatë e refuzojë si të pabazuar pasi gjykata gjeti se paditësja përveç dorëzimit të "Projeksioni i pjesëmarrjes së varieteteve në prodhimin e verërave kualitative dhe kulminante" me datë 27.12.2016, numër të protokollit 01-07 në Departamentin për Vreshtari dhe Verëtarin pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për 989.561 L verë të kuqe, e njëjta me datën 30.12.2016 me numër të protokollit 323, në Departamentin për Vreshtari dhe Verëtarin, ka dorëzuar "Projeksionin e Pjesëmarrjes së Varieteteve në Prodhimin e Verërave Kualitative dhe Kulminante Vjelja 2016" edhe për 4.928,128 L verë. Nga kjo rrjedh se paditësja, brenda afatit të

paraparë me nenin 28 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.03/2017, i ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin nevojshëm.

Gjykata si rregull në konfliktin administrativ vendos në bazë të fakteve të gjendjes faktike të vërtetuara nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE
A.nr. 101/18, datë 05.03.2020

Bashkëpunëtore profesionale
Mirjeta Shala

G j y q t a r e
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.